

VENDIM
Nr. 742, datë 20.11.2019

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË SHKATËRRIMIT TË PRODUKTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 30, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteve, me qëllim identifikimin e kushteve të nevojshme për ruajtjen, trajtimin, transportimin dhe shkatërrimin e tyre në mënyrë të tillë që mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të njeriut e të mjedisit të jenë të garantuara.

2. Ky vendim zbatohet për të gjitha produktet joushqimore për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, të cilat i përkasin fushës së veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, sipas legjislacionit për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore dhe legjislacionit për tregtimin e mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

3. Ky vendim nuk zbatohet për substancat kimike, që janë objekt i regjistrimit dhe/ose i autorizimit paraprak dhe produktet kozmetike.

4. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Komisioni i Menaxhimit të Riskut”, komisioni *ad hoc*, që krijohet nga titullari i strukturës përgjegjëse, sipas rregullave të parashikuara në urdhrin nr. 305, datë 30.5.2014, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, “Për procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut”;

b) “konsumator”, çdo person, i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin, zanatin ose ushtrimin e profesionit;

c) “mbetje”, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

ç) “mbetje bio”, sipas kuptimit të dhënë në vendimin nr. 608, datë 17.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret e afatet për pakësimin e tyre”;

d) “struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut në fushën produkteve joushqimore” (më poshtë struktura përgjegjëse), Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;

dh) “shkatërrim”, çdo operacion që nuk është rikuperim, edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore rikuperimin e substancave ose të energjisë.

II. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

5. Procesi i shkatërrimit të produkteve menaxhohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, duke mos vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e njeriut e duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë apo mjedisin dhe, sidomos,:

a) duke mos vënë në rrezik ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët;

b) duke mos ndikuar negativisht mbi fshatin ose vendet me interes të veçantë;

c) duke mos shkaktuar shqetësime nëpërmjet zhurmave ose erërave, në përputhje me përcaktimet e akteve të tjera ligjore apo nënligjore.

6. Në përputhje me detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për tregtimin dhe për mbikëqyrjen e produkteve joushqimore, struktura përgjegjëse vendos për shkatërrimin e produktit që paraqet rrezik serioz, kur është e nevojshme.

7. Struktura përgjegjëse konsultohet, paraprakisht, me operatorët ekonomikë, strukturat këshilluese, që operojnë në nivel mbikëqyrës dhe me Komisionin e Menaxhimit të Riskut, i cili funksionon pranë saj, lidhur me procesin e shkatërrimit, me qëllim që të sigurojë se produktet përmbushin kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullore.

8. Operatori ekonomik përgjegjës mbulon shpenzimet për shkatërrimin e produktit në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin e produkteve joushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit.

9. Operatori ekonomik përgjegjës nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e shkatërrimit të produkteve edhe në rastin kur kjo procedurë kryhet nga struktura përgjegjëse ose operatorë të licencuar për shkatërrimin e tyre.

10. Miratimi i një procedure shkatërrimi produkti nga struktura përgjegjëse udhëhiqet nga parimet e përgjithshme të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, veçanërisht, bazuar në parimin:

- a) për menaxhimin e produkteve sipas hierarkisë së përparësive;
- b) e afërsisë dhe vetëtrajtimit;
- c) ndotësi paguan;
- ç) e përgjegjësisë së prodhuesit dhe zotëruesit;
- d) e sigurimit financiar.

11. Në çdo rast, procedura për shkatërrimin e produktit bëhet efektive/ekzekutohet, kur vendimi i strukturës përgjegjëse nuk është ankimuar në rrugë gjyqësore ose është lënë në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë.

III. RUAJTJA, TRANSPORTIMI DHE METODAT E SHKATËRRIMIT TË PRODUKTEVE

12. Në produktet e destinuar për shkatërrim përfshihen, ato:

- a) që paraqesin një rrezik të tillë për sigurinë e konsumatorëve saqë duhen shkatërruar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) për të cilat operatori ekonomik deklaron se modifikimi apo kthimi i produktit është i pamundur.

13. Hapat që duhen të ndërmerren përpara shkatërrimit janë:

a) Vendimi i inspektorit të strukturës përgjegjëse për ndërmarrjen e një procedure shkatërrimi, i cili në çdo rast shoqërohet me rekomandimin e Komisionit të Menaxhimit të Riskut që krijohet si një komision *ad hoc*, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

b) Hartimi i planit të shkatërrimit nga ana e strukturës përgjegjëse, duke përfshirë fondet, kostot, burimet njerëzore, ekspertizën, kohën profesionale, hapësirën, pajisjet, materialet, i cili miratohet nga titullari i strukturës përgjegjëse.

14. Produktet e destinuar për shkatërrim duhet të ruhen të ndara nga produktet e përdorshme në treg.

15. Struktura përgjegjëse regjistron produktet e përcaktuara sipas pikës 14 të këtij vendimi, në një regjistër të veçantë, duke treguar emrin e prodhuesit, datën e refuzimit/kthimit, arsyet e refuzimit si produkt.

16. Produktet duhet të pakëtohen dhe të shënohen qartë, dukshëm “produkt për shkatërrim”.

17. Klasifikimi i mbetjeve të specifikohet sipas kodit të përcaktuar në vendimin nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe mbetjet me përmbajtje bimore dhe organike të etiketohen, sipas vendimit nr. 608, datë 17.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”.

18. Produktet e destinuar për shkatërrim, të vendosura në paketime duhet të ruhen në magazina të dedikuara dhe nuk duhet të qëndrojnë më shumë se sa afati i përcaktuar në planin e shkatërrimit, i cili llogaritet që nga data që vendimi për shkatërrim ka marrë formë të prerë.

19. Vendi i ruajtjes duhet të mbahet i siguarur dhe duhet të jetë i mirëmbajtur, i pastruar dhe i dezinfektuar.

20. Gjatë transportit të produkteve për shkatërrim duhet që paketimet të jenë të mbyllura dhe të etiketohen në mënyrë të qartë e të dukshme me tekstin “produkt për shkatërrim”.

Për transportimin e produkteve të klasifikuara si mbetje jo të rrezikshme, gjeneruesi i mbetjeve duhet të plotësojë kërkesat e vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, dhe për transportimin e produkteve të klasifikuara si mbetje të rrezikshme, gjeneruesi i mbetjeve duhet të plotësojë kërkesat e vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”.

21. Para transportimit duhet të sigurohet që paketimi nuk është dëmtuar.

22. Automjeti që bën transportimin duhet t’i përshtatet llojit të produktit dhe të jetë i mirëmbajtur, i pastruar dhe i dezinfektuar. Në rast të transportit të produkteve të klasifikuara si mbetje të rrezikshme, plotësohen edhe kërkesat e nenit 23, të ligjit nr. 10463/2011, të ndryshuar.

23. Procesi i transportimit të produkteve për shkatërrim duhet të mbikëqyret nga një inspektor i strukturës përgjegjëse për tregun, një inspektor mjedisi dhe policia vendore, nga operatori ekonomik deri te vendi i shkatërrimit.

24. Produktet e destinuar për shkatërrim trajtohen në përputhje me legjislacionin për mjedisin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve në fuqi. Shkatërrimi i produkteve bëhet nga personat fizikë ose juridikë, të pajisur me leje mjedisore të tipit III.1 dhe licencë III.2.B, në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet dhe licencat, në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) Nëpërmjet lendfillit, i cili plotëson kërkesat e vendimit nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lendfilllet e mbetjeve”, të ndryshuar, sipas kategorisë së lendfillit (i rrezikshëm, jo i rrezikshëm dhe inerte).

b) Nëpërmjet impiantit të incinerimit, i cili plotëson kërkesat e vendimit nr. 178, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për incinerimin e mbetjeve”.

c) Trajtimi i mbetjeve bio bëhet nëpërmjet trajtimit aerobik, në prani të oksigjenit, ose anaerobik, në mungesë të oksigjenit.

IV. PROCEDURA PËR APLIKIM DHE SHKATËRRIMI I PRODUKTEVE

25. Shkatërrimi i produkteve kryhet nga struktura përgjegjëse nëpërmjet një personi, fizik ose juridik, i licencuar, që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e mjedisit dhe lejet mjedisore.

26. Për shkatërrimin e produkteve, nga çdo person që përmbush kushtet sipas pikës 25, të këtij vendimi, që merr përsipër mbi bazën e njoftimit të strukturës përgjegjëse, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, ndiqet kjo procedurë:

a) personi paraqet kërkesë me shkrim/shprehje interesi pranë strukturës përgjegjëse;

b) kërkesa shoqërohet edhe me listën e konfirmuar të produkteve që do të shkatërrohen dhe elemente të tjera identifikuese të produktit;

c) me marrjen e kërkesës, struktura përgjegjëse, bazuar në kostot e përcaktuara në planin e shkatërrimit, i njofton kërkuarit datën, pagesën përkatëse të procesit, si dhe elementet e tjera të specifikuar në këtë plan, të përshtatura sipas specifikave të llojit të produktit që do të shkatërrohet;

ç) personi njofton datën e shkatërrimit tek operatori ekonomik, struktura përgjegjëse për tregun, struktura mbikëqyrëse për mjedisin, bashkia dhe policia vendore;

d) kur data për shkatërrim konfirmohet nga të gjitha institucionet e listuara në shkronjën “ç”, struktura përgjegjëse për tregun dhe ajo për mjedisin, përfaqësuesi i operatorit, bashkisë dhe policisë mbikëqyrin procesin e shkatërrimit (grupi i punës);

dh) përpara shkatërrimit të produktit, grupi i punës verifikon gjithë informacionin e kërkuar për produktet për identifikimin e llojit të tyre dhe metodën e shkatërrimit që duhet përdorur sipas kërkesave ligjore në fuqi.

27. Struktura përgjegjëse, për ndjekjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim kërkon nga të gjitha institucionet e listuara në shkronjën “ç”, të pikës 26, të këtij vendimi, caktimin e personit përgjegjës nga titullarët e institucioneve, të cilët do të përbëjnë grupin e punës.

28. Struktura përgjegjëse bën klasifikimin dhe verifikimin e produkteve në ambiente të hapura ose të ajrosura. Verifikimi duhet të përmbajë këto elemente:

- a) identifikimin e produkteve;
- b) ndarjen dhe klasifikimin e produkteve sipas metodës së shkatërrimit;
- c) pajisjen e stafit, i cili do të merret me ndarjen dhe klasifikimin e produktit, me mjetet mbrojtëse për shëndetin, si doreza, çizme, maska etj.;
- ç) paketimin e produkteve për shkatërrim me etiketat dhe shënimin përkatës për metodën e shkatërrimit;
- d) ruajtjen e materialeve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore;
- dh) marrjen përsipër të kostos së shkatërrimit/ pagesën nga operatori ekonomik.

29. Pas verifikimit të gjithë anëtarët e grupit të punës duhet të nënshkruajnë një format verifikimi/procesverbal.

30. Procesi i shkatërrimit mbikëqyret nga një inspektor i strukturës përgjegjëse, një inspektor mjedisi dhe policia vendore, si dhe nga operatori te vendi i shkatërrimit.

31. Pas konstatimit të përfundimit të shkatërrimit, një procesverbal duhet të nënshkruhet nga mbikëqyrësit dhe përfaqësuesi i operatorit.

32. Kopje të procesverbalit i dërgohen operatorit, strukturës mbikëqyrëse dhe bashkisë së qytetit.

33. Çdo ankesë për vendimet e marra në të gjitha fazat e procesit, përpara shkatërrimit do të trajtohet sipas procedurës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi për produktet joushqimore dhe inspektimin.

34. Çdo ankesë për vendimet/urdhërimet/ndalimet e marra gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të procesit të shkatërrimit do të trajtohet sipas procedurës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mjedisin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

35. Ngarkohet struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe